

Instruksion Operacional

PLATFORMA E KREDIDHËNIES DIGJITALE

Produkti
Kartë Krediti



HYRJA NË PLATFORMËN DIGJITALE TË TIRANA BANK

Hapni faqen e hyrjes në platformën digjitale të Tirana Bank (udhëzimet shoqëruese janë të ilustruara me pamje ekrani).

1. Plotësoni:

- Emrin e përdoruesit
- Fjalëkalimin

2. Klikoni butonin “Hyr”.

Nëse nuk e mbani mend fjalëkalimin, klikoni te “Po has ndonjë vështirësi?” për ta rikuperuar.

Nëse jeni përdorues i ri, klikoni “Regjistrohu në platformën digjitale” për të krijuar një llogari”.



English ▾

Log in to online banking

You'll need your username and password

Username

jsaif

Password

.....

Log in

Having problems? ▾

New to online banking? [Register for online banking](#)

FAQJA KRYESORE (DASHBOARD)

Pasi klienti hyn në platformën digjitale, në ekran shfaqet Faqja kryesore (Dashboard).


Paneli është i organizuar në disa menu kryesore:

- Faqja kryesore
- Transferta
- Llogari
- Të dhëna
- Vetëshërbim
- Produkte


Në krye të faqes ndodhet menuja e navigimit.

Për të nisur procesin e aplikimit për kartë krediti, klienti duhet të zgjedhë menunë “Produkte”.

Menjëherë pas klikimit, shfaqen opsionet e disponueshme për aplikim.




Në panelin në të djathtë, klienti mund të zgjedhë gjuhën Shqip ose English, të ofruara nga platforma.



APLIKO PËR KREDI OSE KARTË KREDITI

Për të vazhduar me aplikimin për kartë krediti, klienti duhet të zgjedhë opsionin “Apliko për Kredi ose Kartë Krediti”.

Pas këtij veprimi, klienti kalon në hapin tjetër, ku mund të zgjedhë llojin e produktit për të cilin dëshiron të aplikojë.



Zgjedhja e produktit

Në këtë hap, klienti shfaqet në faqen “Produkte”, ku ofrohen dy opsione aplikimi:

- Kredi Konsumatore e Pasiguruar
- Kartë Krediti


Secili produkt paraqitet me një përshkrim të shkurtër dhe me butonin përkatës për nisjen e aplikimit.

Për të vijuar me aplikimin për kartë krediti, klienti duhet të zgjedhë kutinë përkatëse të produktit “Kartë Krediti”.

Zgjedhja e këtij opsioni hap formularin digjital dhe hapat e mëtejshëm të nevojshëm për aplikimin online.

Le të fillojmë / Më shumë detaje


Produkte



Kredi Konsumatore e Pasiguruar
Ke një ide, dëshirë apo nevojë që kërkon mbështetje? Kërkesa për kredi është vetëm një klik larg. Zgjidh vetë shumën dhe afatin që të përshtatet.

[Më shumë detaje](#)

[Le të fillojmë](#)



Kartë Krediti
Kërkon një zgjidhje të përshtatshme për blerjet e përditshme apo planet afatgjata? Karta e kreditit është tashmë e disponueshme për aplikim online. Ti vendos kur dhe si të nisësh.

[Më shumë detaje](#)

[Le të fillojmë](#)

Nëse klienti ka nevojë për më shumë informacion mbi produktin, mund të klikojë “Më shumë detaje” për të parë kushtet dhe specifikimet e kartës së kreditit përpara se të nisë aplikimin.

Faqja informuese për kartat e kreditit

Pas zgjedhjes së opsionit “Më shumë detaje”, klienti hap faqen informuese të dedikuar për kartat e kreditit të Tirana Bank.

TIRANA BANK

Kartat e Kreditit të Tirana Bank

Faqja Kryesore

Tirana Bank ofron 3 lloje kartash krediti, të krijuara për t'iu përshtatur nevojave dhe stilit të jetesës së çdo klienti. Me kartat e kreditit të Tirana Bank, përfiton fleksibilitet, siguri dhe komoditet kudo që ndodhesh.

- **Visa Classic Co-Branded** - një zgjidhje praktike dhe e sigurt, e lidhur me programin më të madh të besnikërisë në Shqipëri, HAPPY, për të përfutur sa herë që përdor kartën.
- **Visa Gold** - zgjidhja ideale për klientët që kërkojnë standarde më të larta, prestigj dhe më shumë fleksibilitet.
- **Mastercard World Elite** - karta më premium në treg, e krijuar për ata që duan të shijojnë privilegjet dhe përfitimet Premium, sidomos në udhëtime dhe eksperiencë unike.

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim

Për të aplikuar për një kartë krediti, nevojiten dokumentat e mëposhtme (të gjeneruara nga e-Albania):

- Vërtetim për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për individin
- Vërtetim page
- Certifikatë Familjare

Zgjidh kartën që të cilën zgjidhjen më të përshtatshme për ty.

*Kujdes! Huamarrja e parave kushton para.

Kjo faqe përmban:

- përshkrimin e llojeve të kartave të kreditit,
- përfitimet e secilës prej tyre,
- si dhe dokumentacionin e nevojshëm për aplikim

Llojet e kartave të kreditit

Në këtë seksion paraqiten tre lloje kartash krediti të ofruara nga banka:

- Visa Classic Co-Branded – kartë praktike dhe e sigurt, e lidhur me programin e besnikërisë HAPPY, që mundëson përfitime sa herë që përdoret.
- Visa Gold – kartë e përshtatshme për klientët që kërkojnë standarde më të larta dhe fleksibilitet më të madh në përdorim.
- Mastercard World Elite – kartë premium që ofron privilegje dhe përfitime shtesë, veçanërisht për udhëtime dhe eksperiencë ekskluzive.

Dokumentacioni i nevojshëm

Klientit i kërkohet të disponojë dokumentet standarde të gjeneruara nga e-Albania, si:

- Vërtetim për kontribute të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore (për individin)
- Vërtetim page
- Certifikatë familjare

Le të fillojmë

Pasi klienti zgjedh të nisë procesin për kartë krediti duke klikuar mbi butonin “Le të fillojmë”, shfaqet një faqe e dedikuar që paraqet dokumentet e detyrueshme për të vijuar me aplikimin online.

Kjo faqe përmban tre elemente kryesore:

- Vërtetim page – dokument që tregon të ardhurat mujore të aplikuesit. Mund të gjenerohet përmes platformës e-Albania, duke klikuar lidhjen përkatëse.
- Vërtetim për pagimin e kontributeve për individin – dokument që vërteton kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore. Gjenerohet nga e-Albania përmes lidhjes së ofruar.
- Certifikatë familjare – dokument i nevojshëm për të konfirmuar përbërjen familjare të aplikuesit. Sigurohet gjithashtu nga e-Albania përmes lidhjes përkatëse.

Çfarë nevojitet për të aplikuar

Për të aplikuar për kartë krediti, nevojiten këto dokumenta:

- ✓ Vërtetim page. Dokumenti mund të gjenerohet **këtu**.
- ✓ Vërtetim për pagimin e kontributeve për individin. Dokumenti mund të gjenerohet **këtu**.
- ✓ Certifikatë familjare. Dokumenti mund të gjenerohet **këtu**.

Qëllimi i këtij hapi është që klienti të sigurohet se i ka të gjitha dokumentet gati për ngarkim ose verifikim përpara se të vazhdojë me aplikimin. Në fund të faqes shfaqet butoni **“Fillo”**, i cili e çon klientin drejt formularit të aplikimit.

Konfigurimi i kartës
1 nga 6

Të dhënat personale

Rishikimi i ofertës

Vlerësimi i ofertës

Nënshkrimi elektronik

Para se të pranosh dokumentin, sigurohu që ke lexuar përmbajtjen e tij.

i Nëse ke pyetje në lidhje me përmbajtjen e dokumentacionit, na kontakto në **+355 4 2277 700** ose vizito një degë.

• **Kushtet e Punës së Kartës së Kreditit**
Të lutem lexo dhe rishiko dokumentacionin për të vijuar më tej.

Pranoj që kam lexuar dokumentacionin e përmendur më sipër
Duke klikuar kutinë dhe butonin “Vazhdo” më poshtë, po përdor nënshkrimin tim elektronik, i cili ka të njëjtin efekt ligjor si nënshkrimi i shkruar me dorë dhe pajtohem me informacionet më sipër.

Vazhdo

Pasi klienti ka kaluar fazën e informimit të dokumenteve të nevojshme, shfaqet faqja ku duhet të rishikohen kushtet dhe dokumentacioni i punës për kartën e kreditit. Kjo faqe është një hap i detyrueshëm që siguron që klienti të jetë njohur me të gjitha termat para se të vazhdojë me aplikimin.

Në këtë seksion shfaqet dokumenti “Kushtet e Punës së Kartës së Kreditit”, i cili duhet hapet detyrimisht nga klienti përpara se të vazhdojë procesin.

Në rast se klienti tenton të vazhdojë pa hapur më parë dokumentin ‘Kushtet e Kartës së Kreditit’, sistemi shfaq mesazhin informues me sfond të kuq “Të lutem rishiko dokumentacionin”.

Ky mesazh njofton se hapja e dokumentit është e detyrueshme për të vijuar me aplikimin.

Rishiko dokumentacionin për kushtet e kartës së kreditit

Konfigurimi i kartës
1 nga 6

Të dhënat personale

Rishikimi i ofertës

Vlerësimi i ofertës

Nënshkrimi elektronik

Para se të pranosh dokumentin, sigurohu që ke lexuar përmbajtjen e tij.

i Nëse ke pyetje në lidhje me përmbajtjen e dokumentacionit, na kontakto në **+355 4 2277 700** ose vizito një degë.

• **Kushtet e Punës së Kartës së Kreditit**
Të lutem lexo dhe rishiko dokumentacionin për të vijuar më tej.

Pranoj që kam lexuar dokumentacionin e përmendur më sipër
Duke klikuar kutinë dhe butonin “Vazhdo” më poshtë, po përdor nënshkrimin tim elektronik, i cili ka të njëjtin efekt ligjor si nënshkrimi i shkruar me dorë dhe pajtohem me informacionet më sipër.

Vazhdo

Konfirmimi i kushteve dhe vijimi i aplikimit

Butoni “Vazhdo” mbetet i çaktivizuar derisa klienti të hapë dokumentin “Kushtet e Kartës së Kreditit” dhe të shënojë kutinë e konfirmimit.

Klienti nuk mund të vijojë më tej pa u njohur me dokumentacionin, pavarësisht se brenda dokumentit janë të disponueshme opsionet “Refuzoj” dhe “Pranoj”. Vetëm pasi dokumenti të hapet dhe të përzgjidhet kutia e konfirmimit, sistemi lejon vazhdimin e aplikimit.

Në pjesën e poshtme të faqes ndodhet kutia e konfirmimit: “Pranoj që kam lexuar dokumentacionin e përmendur më sipër”, e cila duhet të shënohet për të vijuar.


Duke shënuar këtë kuti dhe duke klikuar butonin “Vazhdo”, klienti jep pëlqimin për përdorimin e nënshkrimit elektronik, i cili ka të njëjtin efekt ligjor si nënshkrimi me dorë për dokumentet përkatëse.

Ky hap është thelbësor, pasi përmbledh përgjegjësitë, tarifat, kushtet e përdorimit dhe të drejtat e klientit në lidhje me kartën e kreditit për të cilën po aplikon.

HAPI 1 NGA 6: KONFIGURIMI I KARTËS

Përzgjedhja e llojit të kartës së kreditit

Në këtë hap, klienti zgjedh llojin e kartës së kreditit që dëshiron të aplikojë, sipas nevojave dhe preferencave të tij.



Pasi klienti ka pranuar kushtet e produktit, sistemi e drejton në faqen ku duhet të zgjedhë llojin e kartës së kreditit për të cilën dëshiron të aplikojë. Në këtë faqe, produktet paraqiten në formën e një liste kartash, secila e shoqëruar me karakteristikat kryesore.

Ekrani përmban disa alternativa kartash krediti, të organizuara sipas limitit, monedhës dhe përfitimeve. Për secilën kartë paraqiten:

- limiti maksimal i kredisë,
- norma e interesit,
- komisioni vjetor i kartës (për vitin e parë dhe vitet pasuese).

Në këtë hap, klienti duhet të zgjedhë produktin që i përshtatet më së miri nevojave të tij financiare dhe mënyrës së përdorimit.

Kartat shfaqen në ekran

Klienti zgjedh njëren prej tyre duke klikuar në rrethin përkatës pranë produktit të dëshiruar.

Pas përzgjedhjes së kartës, klienti mund të vazhdojë në hapin tjetër të aplikimit.

Karta jote e Kreditit

Karta jote e kreditit

Limiti i kartës

Lekë 30,000

Shuma maksimale 500,000 ALL

Limiti i kartës 30,000.00 Lekë	Komision vjetor i kartës për vitin e parë 0.00 Lekë
Kohëzgjatja e kartës 24 muaj	Komision vjetor i kartës për vitet në vijim 1,500.00 Lekë
Norma e interesit 18.00%	

Paneli në anën e majtë paraqet të gjithë procesin e aplikimit, të ndarë në gjashtë hapa:

- Konfigurimi i kartës
- Të dhënat personale
- Rishikimi i ofertës
- Vlerësimi i ofertës
- Nënshkrimi elektronik
- Statusi përfundimtar

Hapi aktual, "Konfigurimi i kartës", paraqitet i theksuar, ndërsa hapat e tjerë mbeten të zbehur deri në momentin kur do të plotësohen.

Ky panel shërben si një guidë vizuale, duke i mundësuar klientit të kuptojë në çdo moment se në cilën fazë të aplikimit ndodhet dhe sa hapa mbeten deri në përfundim.

Përcaktimi i Limitit të Kartës

Klienti vendos shumën e dëshiruar të limitit të kartës brenda kufijve të lejuar për produktin e përzgjedhur.

Sistemi përditëson në kohë reale informacionin përkatës të kartës, duke paraqitur:

- limitin e kërkuar,
- kohëzgjatjen e kartës,
- normën e interesit,
- komisionin vjetor (për vitin e parë dhe vitet në vijim).

Këto të dhëna sigurojnë transparencë dhe ndihmojnë klientin të përafrojë pritshmëritë e tij financiare.

Në fund të ekranit ndodhet butoni “Vazhdo”, i cili e çon klientin në hapin e dytë: Të dhënat personale.

Rishiko dokumentacionin

Rishiko dokumentacionin për kushtet e kartës së kreditit

Para se të pranosh dokumentin, sigurohu që ke lexuar përmbajtjen e tij.

i Nëse ke pyetje në lidhje me përmbajtjen e dokumentacionit, na kontakto në **+355 4 22 77 700** ose vizito një degë.

• **Kushtet e Punës së Kartës së Kreditit**
Të lutem lexo dhe rishiko dokumentacionin për të vijuar më tej.

Pranoj që kam lexuar dokumentacionin e përmendur më sipër
Duke klikuar kutinë dhe butonin “Vazhdo” më poshtë, po përdor nënshkrimin tim elektronik, i cili ka të njëjtin efekt ligjor si nënshkrimi i shkruar me dorë dhe pajtohem me informacionet më sipër.

Vazhdo

Klienti duhet të rishikojë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Klauzola e pëlqimit paraprak
- Deklarata për përpunimin e të dhënave
- Klauzola për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave
- Klauzola për metodën e përpunimit të të dhënave

Çdo dokument shoqërohet me një lidhje të klikueshme me tekstin: “Të lutem lexo dhe rishiko dokumentacionin për të vijuar më tej.”

Këto dokumente përmbajnë informacion mbi:

- mënyrën e mbledhjes së të dhënave personale të klientit,
- mënyrën dhe qëllimet e përpunimit të tyre,
- të drejtat e klientit mbi të dhënat e tij,
- përdorimin e nënshkrimit elektronik, i cili ka të njëjtën vlerë ligjore si nënshkrimi fizik.

Deklarata për pranimin e dokumentacionit

Në fund të faqes shfaqet kutia e konfirmimit: “Pranoj që kam lexuar dokumentacionin e përmendur më sipër.”

HAPI 2 NGA 6: TË DHËNAT PERSONALE

Plotësimi i informacionit të përgjithshëm

Në këtë hap, klienti plotëson të dhënat e tij personale të nevojshme për vijimin e aplikimit për kartë krediti.

Formulari përmban fushat e mëposhtme:

- Numri i anëtarëve të familjes mbi 18 vjeç

Klienti zgjedh numrin duke përdorur shigjetat pranë fushës. Ky informacion ndihmon në vlerësimin e përgjegjësive familjare të aplikuesit.

- Numri i fëmijëve nën 18 vjeç

Zgjedhja bëhet në të njëjtën mënyrë, përmes shigjetave pranë fushës.

- Zona e banimit

Klienti zgjedh qytetin ose zonën ku banon. Lista përfshin të gjitha zonat administrative (p.sh. Tiranë, zona rurale, qytete të tjera).

- Statusi i banimit

Opsionet mund të përfshijnë:

- Banesa e prindërve
- Qira
- Banesë në pronësi
- Banesë e përbashkët, etj
- Përzgjidh degën ku dëshiron të marrësh kartën (fushë e detyrueshme)
- Kjo është një fushë detyrueshme e plotësueshme. Klienti zgjedh degën e Tirana Bank ku dëshiron të shkojë për të tërhequr kartën pas miratimit.
- Nëse fusha lihet bosh, sistemi shfaq një gabim: "Përzgjidh degën ku dëshiron të marrësh kartën."
- Kodi promocional (opsional)

Kjo fushë përdoret vetëm nëse klienti disponon një kod promocional nga fushatat e marketingut ose partneritetet e bankës.

Të dhëna mbi punësimin

Në këtë seksion përdoruesi jep të dhënat kryesore që lidhen me punësimin e tij aktual.

Të dhëna mbi punësimin

Lloji i punësimit
Specialist

Lloji i kontratës
Me kohë të kufizuar

Sektori i punësimit
Kompani Private

Sektori i industrisë
Shëndetësi

Shëndetësi
Aktivitetet spitalore

A merr të ardhura mujore nga një punë tjetër përveç asaj kryesore, ose ke ndryshuar punëdhënësin gjatë gjashtë muajve të fundit?

Kthehu Vazhdo

Përzgjidhet Lloji i punësimit (p.sh. specialist, punëtor, drejtues).

- Zgjidhet Lloji i kontratës (afatgjatë, pa afat, afatshkurtër).
- Përcaktohet sektori ku punon përdoruesi (privat, shtetëror, etj.).
- Zgjidhet sektori i industrisë ku bën pjesë punëdhënësi.
- Nëse industria ka nën-kategori, përzgjidhet opsioni përkatës.

Kujdes! E vlefshme vetëm në këto raste: aktivizohet pyetja për të ardhura shtesë/ndryshime punësimi vetëm nëse:

- klienti ka punësim të dytë të siguar, ose
- ka pasur punësim të njëpasnjëshëm gjatë 6 muajve të fundit.


Në mungesë të këtyre kushteve, opsioni lihet i çaktivizuar dhe nuk kërkohet plotësim shtesë.

Klikohet “Vazhdo” për seksionin pasues.

Të dhënat mbi shpenzimet

Ky ekran është pjesë e seksionit “Të dhënat personale”, ku klienti deklaron nëse ka shpenzime të tjera mujore të konsiderueshme.

Informacioni i dhënë në këtë hap përdoret për të vlerësuar kapacitetin financiar të klientit për të përballuar dhe administruar një kartë krediti.




The screenshot shows the 'Të dhëna mbi shpenzimet' (Spending Data) screen. On the left, there is a sidebar menu with options: 'Konfigurimi i kartës', 'Të dhënat personale' (selected), and '2 nga 6'. The main content area has the title 'Të dhëna mbi shpenzimet' and a toggle switch for the question: 'Ke shpenzime të tjera të konsiderueshme që të ndikojnë në buxhetin tënd mujor, përveç jetesës, qirasë dhe shkollimit?'. The toggle is currently turned off. At the bottom right, there are two buttons: 'Kthehu' (Back) and 'Vazhdo' (Next).

Në këtë ekran paraqitet pyetja:

“Ke shpenzime të tjera të konsiderueshme që të ndikojnë në buxhetin tënd mujor, përveç jetesës, qirasë dhe shkollimit?”

- Switchi qëndron në pozicionin gri (OFF).
- Nuk shfaqen fusha për plotësim.
- Klienti mund të klikojë menjëherë “Vazhdo”, sepse nuk ka asgjë të detyrueshme për të plotësuar.

Ne rast kur klienti ka shpenzime të plotësuara shfaqet ikona.



The screenshot shows the 'Të dhëna mbi shpenzimet' (Spending Data) screen with the toggle switch turned on. The sidebar menu is the same. The main content area has the title 'Të dhëna mbi shpenzimet' and the toggle switch for the question: 'Ke shpenzime të tjera të konsiderueshme që të ndikojnë në buxhetin tënd mujor, përveç jetesës, qirasë dhe shkollimit?'. The toggle is now turned on. Below the question, there are three form fields: 'Tipi i shpenzimeve' (Spending Type) with a dropdown menu showing 'Shkollim' (Education); 'Shuma' (Amount) with an information icon and a text input field containing '200.00'; and 'Monedha' (Currency) with a dropdown menu showing 'ALL'. At the bottom right, there are two buttons: 'Kthehu' (Back) and 'Vazhdo' (Next).

Kur klienti aktivizon switchin:

- butoni bëhet jeshil,
- dhe sistemi shfaq automatikisht fushat e detyrueshme për plotësim:
- Tipi i shpenzimeve
- Shuma mujore
- Monedha: Zgjidhet: ALL / EUR)

Pasi janë plotësuar shpenzimet zgjidhet opsioni “Vazhdo”

Ngarkimi i dokumenteve të detyrueshëm

Në këtë hap, klienti duhet të ngarkojë tre dokumentet zyrtare të kërkuara për vlerësimin e aplikimit për kartë krediti.

Secili dokument duhet të:

- të jetë në format PDF,
- të jetë i shkarkuar nga platforma e-Albania,
- të ketë datë të vlefshme.

Dokumentet e kërkuara

Sistemi paraqet tre seksione të veçanta:

1. Vërtetim page për punësimin kryesor

Dokument që tregon të ardhurat mujore të klientit.

Shkarkohet nga: e-Albania → Vërtetim page

2. Kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore

Dokument për individin, i përditësuar.

Shkarkohet nga: e-Albania → Statusi i kontributeve

3. Certifikatë familjare

Dokument zyrtar për përbërjen familjare.

Shkarkohet nga: e-Albania → Certifikata familjare

Çdo seksion përmban butonin:


- “Shto dokumentet” / “Vijo me ngarkimin”

Klienti duhet të ngarkojë nga një dokument për secilin seksion. Sistemi nuk lejon ngarkimin e më shumë se një dokumenti për çdo seksion.

Statusi i ngarkimit të dokumenteve

Pas ngarkimit të suksesshëm, dokumentet paraqiten me statusin:

“Përfundoi” – Dokumenti u ngarkua me sukses.




Dokumentet e paraqitura me këtë status konsiderohen të vlefshme dhe të gatshme për vijimin e procesit. Pasi të jenë ngarkuar të gjitha dokumentet, klienti mund të vazhdojë duke klikuar butonin “Vazhdo”.

HAPI 3 NGA 6: RISHIKIMI I OFERTËS

“Po përpunojmë kërkesën tënde”

Në këtë hap, sistemi përpunon të dhënat dhe dokumentet e paraqitura nga klienti për të gjeneruar ofertën përkatëse të kartës së kreditit.



Në këtë ekran shfaqet një mesazh që informon klientin për përpunimin e kërkesës. Gjatë kësaj faze kryhet rishikimi dhe verifikimi i të dhënave të paraqitura nga klienti. Sapo përfundojnë verifikimet, sistemi njofton klientin automatikisht, në varësi të rezultatit të aplikimit.

Oferte e personalizuar per ty

Pasi sistemi perpunon te gjitha te dhënat dhe dokumentet e klientit, shfaqet ekrani me ofertën finale të personalizuar për kartën e kreditit.



Ky është një nga hapat më të rëndësishëm të procesit, pasi klienti duhet të zgjedhë njërën nga alternativat e propozuara, në përputhje me nevojat dhe mundësitë e tij financiare.

Zgjedhja e ofertës

Në këtë fazë, sistemi mund të:

- miratojë kërkesën e klientit sipas limitit të kërkuar, ose
- sugjerojë një limit më të lartë ose më të ulët, bazuar në vlerësimin e aftësisë paguese, të ardhurave dhe dokumentacionit.

Klienti duhet të zgjedhë njërën nga ofertat e paraqitura, duke klikuar rrethin përkatës në të majtë të secilit opsion.


Sistemi nuk lejon vijimin e procesit pa u përzgjedhur një ofertë.

Pasi bëhet zgjedhja, klienti klikon butonin "Vazhdo" për të kaluar në hapin tjetër.

Rishikimi i dokumentacionit

Në këtë fazë, klienti duhet të sigurohet që ka lexuar dhe pranuar dokumentacionin e nevojshëm për vijimin e aplikimit.

Ekrani paraqet të gjithë informacionin që klienti duhet të ketë parasysh përpara se të vazhdojë.



Lexoni me kujdes dokumentacionin e listuar në këtë hap

Këtu përfshihet dokumentacioni informues dhe kushtet përkatëse të produktit.

- Klikoni mbi linkun “Informacion parakontaktor” për të parë detajet e dokumenteve që do të nënshkruhen në vijim.
- Vendosni shenjën ✓ te kutia e konfirmimit: “Pranoj që kam lexuar dokumentacionin e përmendur më sipër”

Ky hap është i detyrueshëm për të vijuar me aplikimin. Pasi të keni përfunduar, klikoni butonin “**Vazhdo**” në fund të faqes.


Përmbledhja e aplikimit

Në këtë hap, klienti shikon një përmbledhje të plotë të aplikimit për kartën e kreditit.

Përmbledhja e aplikimit

Kjo është përmbledhja e aplikimit tënd për kartë krediti. Të lutem lexo me kujdes dhe kontrollo të gjitha detajet përpara se të dërgosh aplikimin.

Përmbledhja e aplikimit për LEONORADEDJA



Limiti i kartës	30,000.00 Lekë	Tipi i kartës	Kartë Krediti Visa Classic Co-Branded në Lekë
Kohëzgjatja e kartës	24 muaj	Monedha	ALL
Norma e interesit	16.00%	Komision vjetor i kartës për vitin e parë	0.00 Lekë
Norma Efektive e Interesit	23.45%	Komision vjetor i kartës për vitet në vijim	1,500.00 Lekë
Dega ku dëshiron të marrësh kartën	Berat-Dega Berat		

Tërhiq **Konfirmo**

Të gjitha informacionet kryesore të produktit paraqiten në mënyrë të qartë, në mënyrë që klienti të verifikojë saktësinë e të dhënave përpara dërgimit të aplikimit.

Klienti kontrollojnë:

- limitin e kartës së përzgjedhur,
- tipin e kartës së kreditit.

Gjithashtu paraqiten edhe kushtet financiare të produktit, duke përfshirë detajet për to.


Shfaqet një dritare popup me pyetjen:

- “E pranon ofertën e kredisë?”
- Mesazhi informon se, në rast konfirmimi, aplikimi do të dërgohet për vlerësimin përfundimtar.
- Butoni “Kthehu” i lejon klientit të rishikojë informacionin përpara pranimit.
- Butoni “Dërgo” finalizon konfirmimin dhe e dërgon aplikimin drejt fazës së vlerësimit të brendshëm.

Pas klikimit të “Dërgo”, klienti nuk mund të ndryshojë më të dhënat e aplikimit.

HAPI 4 NGA 6: VLERËSIMI I OFERTËS

Në këtë hap, sistemi kryen verifikimin e të dhënave të futura nga klienti gjatë procesit të aplikimit.




Ky proces përfshin kontrollin e saktësisë së informacionit personal dhe të të dhënave financiare.

Paralelisht, realizohet edhe vlerësimi i ofertës, ku zhvillohet analiza e brendshme për përcaktimin e kushteve përfundimtare të kartës së kreditit.

Po përpunojmë kërkesën tënde

Ikona e shfaqur më poshtë tregon se ekipi ynë është duke shqyrtuar kërkesën tuaj.



Pasi këto kontrole të përfundojnë, klienti ridrejtohet automatikisht në hapin tjetër të aplikimit, pa pasur nevojë për asnjë veprim shtesë.

Urime! Karta jote e kreditit u aprovua me sukses

Në këtë fazë, klienti njoftohet se aplikimi për kartë krediti është aprovuar me sukses dhe se duhet të përfundojë procesin brenda afatit të përcaktuar. Ekranin udhëzon klientin të vijojë me identifikimin elektronik, i cili është i nevojshëm për nënshkrimin e dokumenteve.

Pasi të kryhet verifikimi, klienti mund të nënshkruajë dokumentet për finalizimin e kartës përmes opsionit të nënshkrimit elektronik.

Urime! Karta jote e kreditit u aprovua me sukses

⚠ Sigurohu të firmosësh brenda 48 orëve nga momenti i këtij njoftimi.

Identifikimi elektronik

Të lutem vijo me verifikimin e identitetit për të nënshkruar dokumentet dhe finalizimin e kartës së kreditit.

Identifikohu

Firmosja

Të lutem vijo me firmosjen e dokumenteve për krijimin e kartës tënde të kreditit.

Firmos dokumentet

TIRANA BANK

Karta e kreditit nuk u aprovua

Në këtë hap, klienti njoftohet se kërkesa për kartë krediti nuk është aprovuar. Ekranin shfaq një mesazh falënderimi për besimin dhe udhëzon klientin të paraqitet në degën më të afërt të Tirana Bank për të marrë informacion të detajuar mbi vendimin.

Klienti ka gjithashtu mundësinë të mbyllë ekranin ose të përdorë kontaktet e ofruara për të marrë asistencë të mëtejshme.

Karta e kreditit nuk u aprovua

Na vjen keq që karta e kreditit nuk u aprovua. Faleminderit për besimin.

Paraqitu në degën më të afërt të Tirana Bank për më shumë informacion.

Adresa elektronike

Telefoni

HAPI 5 NGA 6: IDENTIFIKIMI ELEKTRONIK (NËNSHKRIMI ELEKTRONIK)


Në këtë hap, klienti udhëzohet të kryejë verifikimin e identitetit për të vijuar me nënshkrimin elektronik të dokumenteve.

Ekranin paraqet butonin "Identifikohu", i cili e drejton klientin në procesin e verifikimit të identitetit, të nevojshëm për finalizimin e kartës së kreditit.

Ky veprim është i detyrueshëm dhe garanton përfundimin e sigurt dhe ligjërish të vlefshëm të aplikimit.

Pranimi i njoftimit për përpunimin e të dhënave (GDPR)

Në këtë fazë, pasi klienti klikon butonin "Identifikohu", i paraqitet dokumenti i privatësisë (GDPR).



Ky dokument shpjegon mënyrën e mbledhjes, përpunimit dhe mbrojtjes së të dhënave personale të klientit, si dhe të drejtat që ai ka mbi këto të dhëna.

Klienti duhet të lexojë informacionin e ofruar dhe më pas të zgjedhë nëse pranon apo refuzon kushtet e përpunimit të të dhënave.


Në fund të faqes shfaqen dy opsione:

- **"Refuzo dhe dil"**, nëse klienti nuk dëshiron të vazhdojë me procesin.
- **"Pranoj"**, për të vijuar në hapin e radhës të Aplikimit.

Verifikimi i identitetit

Në këtë faqe, klientit i kërkohet të kryejë verifikimin e identitetit, i cili është i nevojshëm për të mundësuar nënshkrimin elektronik të dokumenteve të kartës së kreditit.

Në ekran shfaqet titulli: VERIFIKIMI I IDENTITETIT



Sistemi informon klientin se:

- identiteti duhet të verifikohet për arsye sigurie;
- procesi realizohet në mënyrë digjitale;
- rekomandohet përdorimi i telefonit celular për një përvojë më të lehtë.

Mënyra e verifikimit

Klienti ka dy mundësi për të vazhduar procesin

1. Vazhdo në celular

- Klienti klikon butonin "Vazhdo në celular"
- Sistemi ridrejton procesin e verifikimit në telefonin celular
- Në celular kryhen hapat e nevojshëm për identifikim (p.sh. foto e dokumentit të identitetit)

2. Vazhdo në kompjuter


- Nëse klienti nuk ka në dispozicion telefonin celular:
- Klikon linkun "kliko këtu"
- Vijon procesin nga kompjuteri që po përdor

Identifikimi elektronik (verifikimi i identitetit)


Në këtë faqe, pasi klienti ka zgjedhur mënyrën e identifikimit (në celular ose në kompjuter), i kërkohet të kryejë verifikimin biometrik të identitetit përmes platformës Namirial.

Në ekran shfaqet mesazhi: "Filloni"

Për të verifikuar identitetin tuaj, duhet të skanoni



Dokumentin tuaj të identitetit



Fytyrën tuaj

Verifikimi biometrik i identitetit

Në ekran shfaqet mesazhi: “Për të verifikuar identitetin tuaj, duhet të skanoni...”
Ky proces shërben për të siguruar që personi që nënshkruan dokumentet është vetë aplikuesi.

Fillimi i procesit

Për të nisur verifikimin:

- klienti klikon butonin “FILLONI”;
- sistemi hap procesin e identifikimit biometrik;
- verifikimi realizohet përmes kamerës së pajisjes.

Gjatë procesit, klienti duhet:

- të lejojë aksesin në kamerë;
- të pozicionohet përpara kamerës sipas udhëzimeve në ekran;
- të skanojë fytyrën dhe dokumentin e identitetit.

Procesi është i automatizuar dhe zgjat vetëm disa sekonda.

Siguria dhe privatësia

Sistemi garanton se:

- të dhënat biometrike përdoren vetëm për qëllime verifikimi;
- informacioni përpunohet dhe trajtohet në përputhje me ligjin nr. 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”;
- të dhënat nuk përdoren për qëllime të tjera.

Vazhdimi i procesit

Pas përfundimit me sukses të verifikimit:

- identiteti i klientit konfirmohet;
- sistemi lejon vijimin me nënshkrimin elektronik të dokumenteve;
- aplikimi kalon në fazën përfundimtare.

Në rast se verifikimi nuk përfundon me sukses:

- klienti njoftohet dhe udhëzohet të përsërisë procesin.

Faqja e përshkruar më sipër paraqitet gjatë përdorimit të platformës në versionin web, në kompjuter.

Për të verifikuar identitetin tuaj, duhet të skanoni



Dokumentin tuaj të identitetit



Fytyrën tuaj

Për të verifikuar identitetin tuaj, duhet të skanoni



Dokumentin tuaj të
identitetit



Fytyrën tuaj

Zgjedhja e dokumentit të identitetit

Në këtë faqe, klientit i kërkohet të zgjedhë llojin e dokumentit të identitetit që do të përdorë për verifikimin biometrik.

Në ekran shfaqet titulli: "Zgjedhja e dokumentit".



Zgjedhja e dokumentit



Karta e Identitetit Shqiptare



Pasaporta



Ky hap është i domosdoshëm për të vijuar me procesin e skanimit dhe verifikimit të identitetit.

Opsionet e dokumentit

Klienti ka në dispozicion dy alternativa:

1. Karta e identitetit shqiptare

Përdoret karta biometrike e lëshuar nga autoritetet shqiptare.

2. Pasaporta

Përdoret pasaporta biometrike, në rast se klienti nuk disponon kartë identiteti.

Klienti duhet të zgjedhë vetëm një dokument, i cili duhet të jetë:

- i vlefshëm;
- në gjendje të mirë fizike;
- i lexueshëm nga kamera gjatë skanimit.

Identifikimi elektronik – Përfunduar me sukses

Ekрани paraqet konfirmimin se identifikimi elektronik është përfunduar me sukses.

Pasi ky hap validohet, klienti udhëzohet të vijojë me nënshkrimin e dokumenteve të nevojshme për finalizimin e aplikimit.

Për të vazhduar, klienti duhet:

- të klikojë opsionin “Firmos dokumentet”,
- dhe më pas të shtypë “Vazhdo” për të kaluar në hapin tjetër të procesit.

The screenshot displays a mobile application interface for Tirana Bank. On the left, a vertical navigation menu lists several steps: 'Konfigurimi i kartës', 'Të dhënat personale', 'Rishikimi i ofertës', 'Vlerësimi i ofertës', 'Nënshkrimi elektronik' (highlighted in blue), '5 nga 6', and 'Statusi përfundimtar'. The main content area features a large heading: 'Urime! Karta jote e kreditit u aprovua me sukses'. Below this, a warning icon and text state: 'Sigurohu të firmosësh brenda 48 orëve nga momenti i këtij njoftimi.' There are two primary sections: 'Identifikimi elektronik', which shows a green checkmark and the text 'Me sukses' and 'Procesi i identifikimit ka përfunduar me sukses'; and 'Firmosja', which includes a document icon, the text 'Të lutem vijo me firmosjen e dokumenteve për krijimin e kartës tënde të kreditit.', and a blue button labeled 'Firmos dokumentet'. At the bottom right, there is a blue button labeled 'Vazhdo' and the Tirana Bank logo.

Nënshkrimi elektronik (firmosja e dokumenteve)

Në këtë faqe, klientit i kërkohet të konfirmojë nënshkrimin elektronik duke futur kodin OTP (fjalëkalim njëpërdorimësh), i cili dërgohet në pajisjen e tij të regjistruar.

Ky hap përfaqëson nënshkrimin përfundimtar të dokumenteve të kredisë.

Mesazhi i konfirmimit

Në ekran shfaqet një dritare (popup) me mesazhin: “Nënshkruani me një certifikatë të disponueshme nga distanca”

Sistemi kërkon që klienti të:

- vendosë kodin OTP në fushën përkatëse;
- verifikojë pajisjen e tij për marrjen e kodit.

Nënshkruani me një certifikatë të disponueshme nga distanca

Futni fjalëkalimin e pajisjes dhe kontrolloni pajisjen tuaj për OTP.

OTP

Transaksioni i juaj (ID: rbPmCh100t) skadon për 4:55

konvertimi do të kryhet me kursin zyrtar të Bankës së Kosovës.

Nënshkruar nga:	KODRA RIGERS
Lëshuar nga:	Test Namirial EU Qualified CA
Koha e nënshkrimit:	13-03-2026 11:11:48
IP adresa:	217.24.249.61

ANULO NËN SHKRUAJ

upload10404747096197163_PreContractDCC.pdf 1 / 7

Në këtë fazë, shfaqen edhe informacionet e mëposhtme:

- Transaction ID dhe koha e vlefshmërisë së saj;
- të dhënat e certifikatës dhe të nënshkruesit;
- data dhe ora e nënshkrimit;
- adresa IP e pajisjes.

Kodi OTP

Për të përfunduar procesin, klienti duhet:

- të presë njoftimin SMS me kodin OTP në pajisjen e tij celular;
- të vendosë kodin në fushën përkatëse brenda afatit të përcaktuar.
- të sigurohet që kodin OTP i vendosur është i saktë për të vijuar me procesin.

Në rast se afati kohor skadon:

- transaksioni anulohet;
- klienti duhet të rifillojë procesin e nënshkrimit duke klikuar butonin “Ridërgo” për të marrë një kod të ri.

The screenshot shows a web interface for a digital signature process. At the top, there is a title "Nënshkruani me një certifikatë të disponueshme nga distanca". Below the title is a warning message in an orange box: "Ka skaduar transaksioni juaj. Ju lutemi, filloni përsëri." Below this, there is a text prompt: "Futni fjalëkalimin e pajisjes dhe kontrolloni pajisjen tuaj për OTP." followed by an "OTP" label and an empty input field. Below the input field, it says "Transaksioni i juaj (ID: rbPmCh1O0t) skadon për 0:00". A box contains the text "Konvertimi do të kryhet me kursin zyrtar të Bankës së Kosovës". Below this is a table of transaction details:

Nënshkruar nga:	KODRA RIGERS
Lëshuar nga:	Test Namirial EU Qualified CA
Koha e nënshkrimit:	13-03-2026 11:14:11
IP adresa:	217.24.249.61

At the bottom right, there are two buttons: "ANULO" and "RIDËRGO".

Veprimet e disponueshme


Klienti ka në dispozicion këto opsione:

1. "Anulo"
 - Ndërpret procesin e nënshkrimit elektronik.
 - Nëse procesi ndërpritet, klienti mund të rikthehet dhe platforma e ridrejton në fazën përkatëse të aplikimit.
2. "Nënshkruaj"
 - Konfirmon kodin OTP dhe përfundon nënshkrimin elektronik.
 - Vetëm pas klikimit të këtij opsioni, dokumenti konsiderohet i firmosur.

Përfundimi i procesit


Pas vendosjes së kodit të fundit OTP:

klienti klikon mbi ikonën "Përfundo", e cila ndodhet në të djathtë të aplikimit; sistemi kërkon konfirmimin për përfundimin e procesit të nënshkrimit.



Përfundo dokumentin

Klienti konfirmon përfundimin e procesit të nënshkrimit duke klikuar mbi butonin “Përfundo”.



Shkarkimi i dokumenteve të firmosura

Pas përfundimit të procesit të nënshkrimit, klienti drejtohet te ikona “Shkarkoni dokumentin”, e cila shfaqet në ekran.

Klienti mund të klikojë mbi secilin dokument për ta shkarkuar dhe ruajtur në kompjuter ose në telefon.

Dokumentet që mund të shkarkohen janë:

- Informacioni Parakontraktor për Kartën e Kreditit
- Kontrata e Kartës së Kreditit
- Klauzola e Pëlqimit Paraprak

Pasi dokumentet shkarkohen, klienti klikon butonin “Mbyllni dhe vazhdoni”, i cili përmbyll procesin e nënshkrimit të dokumenteve.

Shkarkoni dokumentin

Ju faleminderit që nënshkruat me eSignAnyWhere! Pas mbylljes, do të dërgoheni në një pamje tjetër.

- ↓ Dokumenti
- ↓ Gjurma e auditimit
- ↓ Dokumenti & Gjurma e auditimit
- ↓ Dokument & Gjurma e auditimit e mbyllur

Dokumenti(et) origjinal(e)

- ↓ upload10404747096197163_PreContractDCC.pdf
- ↓ upload5084833088176938104_ContractDCC.pdf
- ↓ upload8945493099005305152_BoaConsent.pdf

MBYLLNI DHE VAZHDONI

Konfirmimi i përfundimit të nënshkrimit

Pamja e mëposhtme i tregon klientit se procesi i nënshkrimit të dokumenteve është kryer me sukses.

Dokumentet e firmosura i dërgohen klientit në adresën e tij të e-mail.

Konfigurimi i kartës

Të dhënat personale

Rishikimi i ofertës

Vlerësimi i ofertës

Nënshkrimi elektronik

5 nga 6

Statusi përfundimtar

Urime! Karta jote e kreditit u aprovua me sukses

⚠️ Sigurohu të firmosësh brenda 48 orëve nga momenti i këtij njoftimi.

Identifikimi elektronik

✓ Me sukses

Procesi i identifikimit ka përfunduar me sukses

Firmosja

✓ Me sukses

Procesi i nënshkrimit elektronik ka përfunduar me sukses

TIRANA BANK

Vazhdo


Nënshkrimi – Përfunduar me sukses

Pasi dokumentet janë nënshkruar elektronikisht, sistemi konfirmon se firmosja është kryer me sukses dhe të gjitha dokumentet e nevojshme janë finalizuar. Klienti mund të vijojë me hapin përfundimtar të aplikimit duke klikuar butonin “Vazhdo”, pa pasur nevojë për veprime shtesë.

HAPI 6 NGA 6: STATUSI PËRFUNDIMTAR

Karta e kreditit po krijohet.

Në këtë fazë finale, sistemi informon klientin se karta e kreditit është në proces krijimi.




Në këtë hap final, klienti njoftohet se karta e kreditit është duke u krijuar dhe se do të informohet nga dega e përzgjedhur sapo karta të jetë gati për t’u tërhequr. Afati i përgatitjes së kartës është zakonisht rreth 10 ditë pune. Ekranu përfundon me opsionin “Përfundo”, i cili mbyll procesin e aplikimit dhe konfirmon se të gjitha veprimet e nevojshme janë kryer me sukses. Klienti duhet të paraqitet në degën e përzgjedhur për të tërhequr kartën e kreditit.

Rikthimi në aplikim (pas ndërprerjes së sesionit)

Në rast se platforma mbyllet për shkak të pasivitetit (timeout), shfaqet mesazhi: “Faleminderit që u riktheve”

Klienti ridrejtohet në dashboard, ku mund të vazhdojë aplikimin duke klikuar mbi produktin e kartës së kreditit.

Kjo ikonë shfaqet vetëm në rastet kur sesioni ndërpritet për shkak të pasivitetit.



Kjo ikonë ju ridrejton në secilin prej 6 hapave të aplikimit, ku keni qenë më parë:

- Konfigurimi i kartës
- Të dhënat personale
- Rishikimi i ofertës
- Vlerësimi i ofertës
- Nënshkrimi elektronik
- Statusi përfundimtar

THANK YOU

APRIL 2026